VENDIM
Nr. 544, datë 27.7.2016

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK "GREEN COAST"[1]

(Ndryshuar me VKM nr.394, datë 3.5.2017; nr. 437, 15.7.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse në funksion të realizimit të projektit investues strategjik "Green Coast", Palasë, Himarë, zona kadastrale 1481–1739, i cili ka përfituar statusin e investimit strategjik, procedurë e veçantë, me vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

2. Afati për përdorimin e brigjeve sipas këtij vendimi të jetë *30 (tridhjetë) vjet* duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.1 Bashkia Himarë ka detyrimin që brenda 15 ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik "Green Coast", të lidhin kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi. Pagesa kryhet çdo vit, bazuar në sipërfaqen, objekt përdorimi.

2.1.1 Përjashtimisht, kontrata mund të rishikohet me kërkesë të investitorit strategjik "Green Coast", në rast se kërkohen të shtohen sipërfaqe plazhi në përdorim, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2.2 Së bashku me kërkesën, investitori strategjik "Green Coast" duhet të paraqesë pranë Bashkisë Himarë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstrakt të 3 muajve të fundit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

- Planvendosje të sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;

- Përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.

3. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për turizmin, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Himarë. Kjo tarifë do të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 2.1 dhe 2.2, më sipër, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

5. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik "Green Coast", me NIPT/NUIS: L41329038D, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në përcaktimet e bëra në vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

6. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimet e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimet e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

---

[1] VKM nr.544, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.145, datë 3 gusht 2014.
VKM nr.398, datë 3.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.106, datë 11 maj 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCË NR. 1

KOORDINATAT PËR PROJEKTIN KOORDINATAT PËR PROJEKTIN

"GREEN COAST 1 GREEN COAST 2"

(shtuar me VKM nr. 437, datë 15.7.2021)

Nr.	**E**	**N**
1	464264.309	4448729.419
2	464273.238	4448740.565
3	464293.740	4448725.18
4	464320.479	4448742.914
5	464342.367	4448736.317
6	464344.958	4448723.376
7	464356.809	4448723.360
8	464429.569	4448713.179
9	464453.808	4448682.839
10	464449.109	4448657.603
11	464513.437	4448579.577
12	464534.755	4448560.219
13	464590.104	4448522.941
14	464627.341	4448497.138
15	464636.507	4448479.854
16	464646.193	4448474.645
17	464692.341	4448435.202
18	464697.368	4448428.244
19	464709.890	4448424.637
20	464721.706	4448413.034
21	464736.913	4448375.511
22	464744.122	4448372.083
23	464762.315	4448372.932

Nr.	**E**	**N**
1	464798.401	4448211.494
2	464949.135	4448006.771
3	464901.215	4447975.274
4	464744.679	4448150.807

24	464796.437	4448348.883
25	464777.917	4448313.233
26	464796.147	4448292.185
27	464779.905	4448276.481
28	464794.727	4448236.971
29	464816.744	4448227.085
30	464801.916	4448216.141
31	464744.679	4448150.808
32	464584.515	4448363.303
33	464422.357	4448561.558
34	464320.335	4448678.780